

ADMIRIM DOMI

TEORIA E KOMUNIKIMIT E ROMAN JACOBSONIT DHE SATIRA

Emri i shkencëtarit rus, Roman Jakobson është i lidhur ngushtësisht me atë që njihet si “Teoria e komunikimit”. Se çfarë është teoria e komunikimit e sqaron më së miri vetë Jakobsoni:

“Adresuesi i dërgon një mesazh të adresuarit. Që të vlejë mesazhi kërkohet në radhë të parë një kontekst, të cilit i referohet dhe i cili rroket prej të adresuarit... Mesazhi kërkon një kod të përbashkët tërësisht ose të paktën pjesërisht për adresuesin dhe të adresuarin. Mesazhi kërkon një lidhje, një kanal fizik dhe një bashkëlidhje psikologjike që bën të mundur të vendoset komunikimi”

Bazuar në këtë skemë, Jakobsoni përshkruan edhe gjashtë funksionet përkatëse, që sipas tij janë funksionet themelore të gjuhës.

Faktorët e komunikimit dhe funksionet e gjuhës

Target factor and function no.	TARGET FACTOR	SOURCE FACTOR	FUNCTION
1	Context	Message	Referential
2	Addresser	Message	Emotive
3	Addressee	Message	Conative
4	Contact	Message	Phatic
5	Code	Message	Metalingual
6	Message	Message	Poetic

1. Adresuesi shfaq funksionin emotiv ose shprehës, sepse i bën të njohura idetë dhe dëshirat e veta me gjuhë.

2. Ai mund të përpiqet të veprojë mbi tjetrin dhe të ushtrojë funksionin konativ tek i adresuari

3. Me gjuhë tregohet një gjendje e gjërave, pra ajo i referohet realitetit, kështu që ajo ka edhe funksion referencial

4. Funksioni faktik lidhet me kanalin ose lidhjen fizike të komunikimit.

5. Funksioni poetik është vetëreferim i mesazhit dhe përqendrohet në vetë këtë mesazh

6. Funkzioni metagjuhësor ka po ashtu karakter vetvetor dhe shfaqet atëherë kur vetë kodi i përdorur bëhet objekt i mesazhit.

Qëllimi i kësaj kumtese, nuk është që t'iu njoh me teorinë e komunikimit të Jakobsonit, por të tregojë se si mund të shërbejë njohja e kësaj teorie, për të prodhuar satirë, pra me fjalë të tjera për ti dhënë gjuhës edhe një funksion të shtatë, atë satirik.

Por më parë le të shohim se cili është kuptimi i fjalës *satirë*:

Në fjalorin e gjuhës shqipe me satirë nënkuptohet:

*ironi e hidhur, therëse fshikulluese, qëndrim që shpreh një ironi.*²

Një shpjegim të ngjashëm gjejmë për *satire* edhe tek freedictionary.com/satire.³

Fjala satirë të shpie tek fjala ironi, për të cilën gjejmë këtë shpjegim në fjalorin e gjuhës shqipe “*tallje që bëhet në mënyrë të hollë e të mbuluar, duke folur gjoja me gjithë mend; qesëndi*”⁴.

Bypass shou është një emision satirik i përjavshëm që fillesën e tij e ka që më 1 maj të 2006. Në themel të këtij emision, qëndron tallja, pra ironia jo vetëm me politikën, por me të gjitha fenomenet shqetësuese të shoqërisë. Bypassi i është referuar shpesh herë skemës së Jakobsonit, duke përdorur atë për të prodhuar satirë, pra talljen me politikën dhe fenomenet e tjera shoqërore dhe sociale. Përpara se t'i përgjigjem pyetjes se si është realizuar kjo më lejoni të sjell disa shembuj...

Shembull 1: Bisedë me Presidentin, 15.3.2015

Prezantuesi: *Faleminderit që pranuat ftesën tonë z. Nishani dhe do të doja ta nisja këtë intervistë me një pyetje që besoj është në interes të të gjithëve. Ç'konspiracion fshihet tek fakti i heqjes së mustaqeve tuaja?*

B. Nishani: *Thjeshtë lehtësi, lehtësi për tu përgatitur çdo mëngjes për punë, nuk nevojitet më ai angazhim specifik.*

Prezantuesi: *E drejtë, sepse normalisht mustaqet kanë qenë historikisht një impenjim i madh për shqiptarin. Kaq thjeshtë e vendosët apo ka gisht dikush tjetër në marrjen e këtij vendimi?*

B. Nishani: *Ka një pjesë shumë të vogël nëna e bashkëshortes sime...*

Prezantuesi: *Dhe e besoj se vjehrrat zakonisht kanë shumë peshë në vendimmarrje në familjet shqiptare. Besoj se e kuptuar që kenë kaluar në një stil më trendi?*

B. Nishani: *Po e vërtetë, besoj më afër origjinalit.*

Prezantuesi: *Duke parë në analet e historisë, shoh që edhe paraardhësit e familjes tuaj kanë pasur mustaqe, apo jo?*

B. Nishani: *Bashkëshortja ime padyshim është një pasardhëse e familjes së Qemal Karosmanit, apo Qemal bej Elbasanit, siç njihet tamam me emrin e tij, i cili ka qenë firmëtar i pavarësisë.*

Prezantuesi: *Dhe besoj se familja juaj ka ruajtur kujtime prej tij?*

Teoria e komunikimit e Roman Jacobsonit dhe satira

B. Nishani: *Ka ruajtur me fanatizëm dhe ka trashëguar penën me të cilën është nënshkruar pavarësia, të cilën më pas familja e ka dorëzuar në muzeun kombëtar të vendit.*

Prezantuesi: *Meqë mustaqet tuaja kanë qenë ato të një burri shteti, pra nuk janë mustaqe dosido, a do ti lini trashëgim ato për ti konservuar?*

B. Nishani: *Bashkëshortja ime nuk është trashëgimtare fare.*

Prezantuesi: *Vendimi për të hequr mustaqet, a kishte lidhje me KLD-në?*

B. Nishani: *Jo, s'ka lidhje me KLD-në.*

Prezantuesi: *Thjeshtë mendova se mund të të ketë nxjerrë ndonjë problem institucional.*

B. Nishani: *Nëse do të ishte kështu si e thoni ju, po. Edhe unë do të bashkohesha që ka një problem, por nuk është kështu.*

Prezantuesi: *Pra, e merrni në konsideratë faktin që në një farë mënyre, ato të bekuara mustaqe kanë qenë pak problem.*

B. Nishani: *Nuk është e saktë ajo që thoni, pra. Tani unë po e shpjegoj se cila është e saktë. Po të ishte ajo që thoni ju, unë bashkohem në apriori me krijimin e atij perceptimi. Nuk është ashtu, po e shpjegoj*

Gimi: *Nuk besoj se do të ishte e frytshme të debatonim gjatë për mustaqet e Çelos, ndaj më mirë e anashkalojmë këtë fakt. Besoj se edhe ju ndani të njëjtin mendim me mua, apo jo?⁵*

Shembull 2: Bisedë me Kryeministrin, 22.3.2015

A.B.: *Mirëmbërëma z. Rama, kënaqësi që t'ju kemi në studion tonë.*

E. Rama: *Mirëmbërëma.*

A.B.: *Një javë më parë trajtuam në emisionin tonë procesin e kërcimit. Do të donim një lloj mendimi tuajin rreth këtij procesi.*

E. Rama: *Patjetër, me shumë gatishmëri, madje edhe me kënaqësi që ky proces të hetohet deri në fund dhe që faji mos të mbetet pa fajtor.*

A.B.: *Unë kërkova vetëm një mendim, z. kryeministër, jo një gjykim të çështjes. Them ta lëmë ligjin mënjane kur flasim për procese jo-gjyqësore.*

E. Rama: *Ku ju flisni për ligjin duhet marrë me shumë rezervë, sepse kjo është një çështje e natyrës juridike dhe nuk është një çështje e natyrës gazetareske.*

A.B.: *Edhe unë si gazetar po jua drejtoj pyetjen, ju lutem. Përpiquni ta kuptoni atë për të cilën ju ftoj të bisedojmë.*

E. Rama: *Jo, nuk e kuptoj fare për çfarë diskutojmë, se është njësoj si të më vini ju në zyrë bashkë me një person të panjohur dhe të më thoni se ky personi që kam në krah ka dashur të më vrasë.*

A.B.: *Po e fusim bisedën nëpër ca shtigje të pakuptueshme, z. kryeministër.*

E. Rama: *Më ka treguar se Sandri i ka dhënë disa qindra mijëra euro për të më eliminuar mua me porosi të doktorit, pasi doktori nuk më duron dot më.*

A.B.: *E sigurt kjo që thoni? Po Sandri cili është?*

E. Rama: *Këtë gjë e ka sqaruar ministri i brendshëm qartësisht në deklaratën e djeshme.*

A.B.: Por ama deklarata e atij të cilin ju e quani porositësi i vrasjes thoshte tjetër gjë.

E. Rama: Ku e tha?

A.B.: E dini vetë ju.

E. Rama: Ku e tha?

A.B.: Aty ku thuhet gjërat që nuk thuhet në media.

E. Rama: Ku?

A.B.: Në Parlament, z. Rama, e ku tjetër?

E. Rama: Të citosh parlamentin nuk do të thotë të citosh një burim të besueshëm.

A.B.: Pse, nëse do të ishte cituar jashtë parlamentit, do të ishte i besueshëm?

E. Rama: Nuk jemi për të bërë humor...

A.B.: Sigurisht që jo, por them të mos e humbasim fillin e kësaj bisede.

E. Rama: Kjo është një bisedë kot.

A.B.: Doni që ta mbyllim këtu?

E. Rama: Jo.

A.B.: Atëhere vazhdojmë?

E. Rama: Tani, mund ta mbyllim këtë temë, unë kaq kam.

A.B.: Sapo thatë që të mos e mbyllim.

E. Rama: Kush e tha këtë?

A.B.: Ju, sapo e thatë në mënyrën më të prerë.

E. Rama: Ça ishte kjo tani?

A.B.: Një sqarim i qëndrimit tuaj të pak mëparshëm.

E. Rama: Unë do t'ju kërkoja shumë miqësisht që... dhe do t'ju kujtoja...

A.B.: Nuk ka problem z. Rama, mund ta mbyllim bisedën nëse nuk ndiheni komod.

E. Rama: Shantazh?

A.B.: Absolutisht, këtu jeni në të vetmen hapësirë ku mund të ndiheni i pashantazhuar. Ama do dëshiroja të dija se si do të reagonit në të kundërtën.

E. Rama: Sipas jush në atë moment unë çfarë do të bëj?

A.B.: Na e thoni ju, ju na treguat pak më lart se ju kishin ardhur në zyrë bashkë me një vrasës surprizë.

E. Rama: Jo, ai nuk është shfaqur me një vrasës, ai është shfaqur me një aktor.⁶

Shembull 3: Bisedë me Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin dhe Kryetarin e Opozitës, 28.6.2015

A.B.: Siç e dini, ti kesh këta tre personalitete njëherësh në një studio televizive është praktikisht diçka e pamundur, por për bypassin dhe teknologjinë e tij të figurës HD, 17D, kjo është mëse normale. Ftojme pa humbur kohë kryetarin e parlamentit, z. Ilir Meta. Ftojme atë të parin, pasi siç e ka dhe emrin, ai është i lirë nga çdo kompleks dhe çdo kah partiak. Z. Meta, mirëmbërëma dhe mirëserdhët në studion e Bypassit.

I. Meta: Mirëmbërëma. Mirëmbërëma juve dhe teleshikuesve tuaj të panumërt.

A.B.: Shpresoj të jeni gati për këtë përballje të pashoqe.

I. Meta: Patjetër. Do të përpiqemi t'ju përgjigjemi gjithë interesimit tuaj dhe të teleshikuesve tuaj.

Teoria e komunikimit e Roman Jacobsonit dhe satira

A.B.: Ftojme gjithashtu kryeministrin e vendit, z. Edi Rama. Mirëmbërëma dhe mirëserdhët.

E. Rama: Mirë se ju gjeta.

A.B.: Besoj se edhe ju z. Rama mezi e keni pritur këtë takim, apo jo?

E. Rama: 01:37 – Më në fund kam mundësi të bëj një debat me opozitën se je opozita e vetme që na ka mbetur për momentin.

A.B.: Për momentin ama, pasi nga kreu i opozitës akoma nuk kemi konfirmim për mbëritjen e tij, mbase nuk ka kapur dot tramin... ah, ja ku po vjen.

L. Basha: (futet në studio me duartrokitjet e te rinjve të forumit që e shoqërojnë)

A.B.: Mirëmbërëma z. Basha.

L. Basha: Së pari të falenderoj për ftesën në këtë studio...

A.B.: Është kënaqësi, por përpiquni ta kapni ritmin, se për pak menduam mos na bojkotuat.

L. Basha: Do rregullohet gjatë emisionit, mos ki merak.

A.B.: Shpresojmë që t'ua falë këtë vonesë z. Meta, pasi një nga sloganet e tij në fushatë ka qenë "të ecim më shpejt".

I. Meta: E bëj këtë gjë për hatër të doktorit.

A.B.: Të cilit doktor, kardiologut apo gjinekologut?

I. Meta: Tani, ti ngaqë s'ka opozitë Shqipëria do të marrësh rolin e tyre, pse jo...

A.B.: Ia fala kryeministrit këtë batutë, pasi z. Basha akoma nuk kishte ardhur, por nuk mund ta bëj këtë gjë tani që opozitën e keni përballë.

I. Meta: Tani, z. Basha, e dinë edhe kolegët e vet demokratë, thonë që ky të, ç'pret nga ky, ky të gënjen për qejf. Si të gënjen për qejf? Pyete për orën, tha, po s'ta tha gabim, se ka kënaqësi kur gënjen.

A.B.: Si do ti përgjigjeshit kësaj akuze z. Basha.

L. Basha: Po kush merret me retorikën e Ilir Metës, e pe sa siklet është, e pe që s'kishte as qetësi as dashuri.

A.B.: Atëhere të pyesim z. Rama, si i paanshëm në këtë konflikt. Z. kryeministër, si e shihni këtë opsion mbi orën e kreut të opozitës?

E. Rama: Vetëm një gjë. Kur më thua do të pyes atë për të marrë vesh të vërtetën, më shokon.

A.B.: Pra siç e shikoni z. Basha, edhe kryeministri qenka në një mendje me z. Meta.

L. Basha: Më thuaj me kë rri të të them se cili je. Ky rri me këtë, ai rri me atë, kështu që s'ka nevojë për këto.

A.B.: Ok, vazhdojmë më tej me pyetjet sepse dhe kohën e kemi të kronometruar.

I. Meta: Ora është 11:02 minuta tani, po e pyete atë, thotë është 12 pa pesë.

A.B.: Z. Meta, ju lutem.

I. Meta: Duhet të jemi një çikë më seriozë me qytetarët dhe me fenomenin.

A.B.: Keni plotësisht të drejtë, edhe qytetarët kanë të drejtë që të paktën orën ta dinë me saktësi.

E. Rama: Ç'është ky muhabet idiot?

A.B.: Ju lutem z. Rama, ju ftoj të biem dakord për të mos krijuar çarje të koalicionit. Z. Meta sapo shfaqti shqetësimin e tij për orën.

E. Rama: Ja çfarë do të thotë ta nxjerrësh nga konteksti një fjalë.

A.B.: Unë nuk po nxjerr asgjë nga konteksti, pasi zotin Meta e kam përballë.

L. Basha: Unë them të mos merremi me atë se ti e pe, njëri kishte humbur qetësinë, tjetrit i merrej fryma.

A.B.: Unë mendoj që këtë intervistë ta bëjmë më mirë me radhë, se po u futët në debat, kushedi kur përfundojmë.⁷

Në dukje këta shembuj të krijojnë përshtypjen se kemi një bisedë të thjeshtë midis marrësit të mesazheve dhe dhënësit. Në këta shembuj dhënësin e mesazheve e bëjnë politikanët, ndërsa prezantuesi, pra intervistuesi në rolin e marrësit të mesazhit. Meqenëse biseda shfaqet në një studio televizive, të gjithë ata që po e ndjekin këtë bisedë janë po ashtu marrës të mesazhit.

Nga mesazhet që merr, një publik i vëmendshëm kupton se në bisedë ka diçka që nuk shkon. Në shembullin e parë, është një intervistë me presidentin e Republikës dhe biseda vërtitet rreth mustaqeve të tij. Publiku merr një informacion, por informacioni që ai merr është përtej pritshmërive të tij. Marrja e një mesazhi që shkon përtej pritshmërive, shkakton atë që quhet humor, pasi siç thoshte Aristoteli “*Sekreti i humorit është befasia.*”⁸

Edhe në shembullin e dytë, jemi brenda skemës së Jakobsonit me një dhënës dhe një marrës, por mesazhet që merr publiku, përsëri shkojnë përtej pritshmërisë së tij. Publiku bën lidhjen mes mesazhit dhe dhënësit të mesazhit dhe arrin të kuptojë se përgjigjet e shkurtra, nuk janë tipike për gjuhën e dhënësit të mesazhit, në rastin konkret kryeministrit të vendit.

Në shembullin e tretë kemi jo një, por tre dhënës mesazhesh, ndërsa ai që merr mesazhin është sërish publiku. Ajo çfarë shkon përtej pritshmërive të publikut, nuk ka të bëjë më shumë me mesazhin, por me dhënësin, ose më saktë dhënësit e mesazhit. Për arsye jogjuhësore publiku e di që personazhet të cilët po i japin mesazhe, nuk do të gjendeshin kurrë në të njëjtën studio. Nëse dhënësi i mesazhit, ose dërguesi, do kishte qëllim që të dërgonte një mesazh që të shkaktonte humor tek marrësi, nuk do të kishim asgjë për tu habitur, por duke njohur mirë natyrën e atyre që japin mesazhe, kupton që qëllimi i tyre nuk është ky. Atëherë çfarë ka ndodhur?

Bisedat e sjella për ilustrim në shembujt e mësipërm, nuk janë reale. Ajo çfarë ka ndodhur është një ndërhyrje me dashje në bisedën reale. Në bisedën origjinale, skenaristi i emisionit, ka shkëputur fraza të të intervistuarit të cilat mund të qëndrojnë si fjali më vete dhe që mbartin një mesazh. Ky mesazh është zhveshur nga konteksti. Më pas është hequr nga biseda intervistuesi, ose thënë me gjuhën e Jakobsonit, marrësi dhe është zëvendësuar me një marrës të ri. Qëllimi i tij është që të bëjë të mundur realizimin e një komunikimi të ri. Marrësi në këtë rast nuk është vetëm një pritës i informacionit, por dhe një kanalizues i tij. Pra, në këtë pikë, marrësi nuk është ai klasik i skemës së Jakobsonit, ai është në rolin e një ndërmjetësi, ose më saktë ai bën përthyerjen e bisedës. Në këtë mes duke bërë të

Teoria e komunikimit e Roman Jacobsonit dhe satira

paditurin, ai bën ndërmjetësin mes dhënësit të mesazhit dhe publikut që është realisht marrësi i mesazhit. E thënë më thjeshtë, në këtë skemë dërguesi lëshon një mesazh, i cili është nxjerrë nga konteksti, prezantuesi e fut këtë mesazh në një kontekst të ri dhe ja dërgon atë publikut, pra nga një skemë klasike marrës – dhënës, kalojmë në një skemë të re: dhënës, ndërmjetës dhe marrës. Në rastin tonë ndërmjetësi është edhe marrës dhe dhënës mesazhesh, pra në këtë mes ai luan rolin e pasqyrës, ose sipërfaqes së sheshtë të ujit, pra përtërjetjen e mesazhit

Në këtë që thamë dy elementët kryesorë të teorisë së Jakobsonit, pra dhënësi dhe marrësi nuk ndryshojnë, pra thënë më thjeshtë, ai që jep informacionin është po politikani në studio dhe ai që e merr këtë informacion është publiku. Ajo që ndryshon është thjeshtë mesazhi, i cili me ndërhyrjen e një personazhi, që edhe jep edhe merr, mesazhi nxirret nga konteksti. Publiku, merr dy mesazhe të ndryshme nga i njëjti dërgues, në rastin e bisedës reale, ai merr mesazhin e pastër, ndërsa në të dytin një produkt që është manipuluar qëllimisht, për të bërë që gjuha të ketë edhe një funksion të shtatë, atë sarkastik.

Nëse do ta thosha gjithë këtë me gjuhën e Çomskit⁹, do të thosha se edhe strukturat gjuhësore që i kalojnë kufijtë e frazë apo fjalisë kanë aftësi gjeneruese. Nga një bisedë e lirë midis një dhënësi dhe një marrësi, mund të gjenerosh një pafundësi bisedash, ku dhënësi dhe marrësi nuk ndryshojnë, por ndryshon mesazhi dhe konteksti.

BIBLIOGRAFI

Aristoteli, *Politika*.

Fjalor i Gjuhës Shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.

freedictionary.com/satire.

N. Çomsky, *Aspects of the Theory of Syntax*, 1966.

R. Jakobson, *Closing Statements: Linguistics and Poetics*, in Thomas A. Sebeok, “Style In Language”, Cambridge Massachusetts, MIT Press, 1960, pp. 350–377.

Vizion Plus, *Bypass shou*, <https://www.youtube.com/watch?v=69KEVFYJNsY>

Vizion Plus, *Bypass shou*, <https://www.youtube.com/watch?v=fy2Ia2zi5r8>

Vizion Plus, *Bypass shou*, <https://www.youtube.com/watch?v=g9EymlmH23E>

